Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0849
Data e Vendimit: 15.11.2023

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) WOOD CORPORATION L.L.C., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizimi dhe montimi me inventar te çerdheve" me numër të prokurimit 208 Udheheqesi-23-1185-1-1-1, iniciuar nga MINISTRIA E ARSIMIT, në cilësinë e autoritetit kontraktues, Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Vjosa Gradinaj Mexhuani me datën 15/11/2023, mori këtë:

Vendim

1.Hedhet si e palejuar, ankesa e OE "WOOD CORPORATION" L.L.C. me Nr. të protokollit 2023/0849, e datës 30/10/2023, ankesë kjo e parashtruar për aktivitetin e prokurimit "Furnizimi dhe montimi me inventar te çerdheve", me numër të prokurimit 208 Udheheqesi-23-1185-1-1-1, iniciuar nga MINISTRIA E ARSIMIT në cilësinë e autoriteti kontraktues (AK).

2. I lejohet, autoritetit kontraktues – MINISTRIA E ARSIMIT që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi dhe montimi me inventar te çerdheve", me numër të prokurimit 208 Udheheqesi-23-1185-1-1-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

3. Në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale-

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 30.10.2023 ka pranuar ankesën me Nr.849/23 nga OE ankues WOOD CORPORATION L.L.C. lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi dhe montimi me inventar te çerdheve", me numër të prokurimit 208 Udheheqesi-23-1185-1-1-1, iniciuar nga Ministria e Arsimit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues.

AK me datën 22.09.2023 ka publikuar Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues kurse me datën 28.09.2024 ka publikuar **B**08 Njoftimin për dhënie te kontratës me datën 04.10.2023 ka publikuar B52 -Njoftimin për nënshkrimin e kontratës lidhur me aktivitetin e përshkruar si me sipër.

OE ankues "WOOD CORPORATION" L.L.C. ka parashtruar kërkesë për rivendosje të afatit me datën 05.10.2023 (e cila është refuzuar nga AK duke theksuar nder tjera "*se përdoruesit e sistemit elektronik gjithmonë duhet te kontrollojnë inbox brenda llogarisë se sistemit te prokurimit elektronik dhe gjatë kësaj kohe nuk ka pasur problem/pengese ne funksionimin e sistemit*"), ndërsa kërkesën për rishqyrtim e ka paraqitur me datën 16.10.2023.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Nga provat e prezantuara vërtetohet se për aktivitetin e prokurimit "Furnizimi dhe montimi me inventar te çerdheve", me numër të prokurimit 208 Udheheqesi-23-1185-1-1-1, iniciuar nga Ministria e Arsimit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues me datën 22.09.2023 ka publikuar Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues.

Zyra për pranimin e ankesave, pas pranimit të ankesës, gjatë verifikimit nëse ankesa është dorëzuar sipas rregullave dhe dispozitave ligjore, ka konstatuar se ankuesi kërkesën për rishqyrtim tek Autoriteti Kontraktues e ka paraqitur me datën 16.10.2023, jashtë afateve ligjore. OE ankues ka qenë i obliguar që në pajtim me paragrafin 3.2 të nenit 108/A të LPP-së, brenda afateve ligjore të parashtroj kërkesë për rishqyrtim në AK dhe vetëm pas udhëheqjes së procedurave paraprake në AK, Operatori ekonomik në pajtim me nenin 109 të LPP-së do të mund ti drejtohet me ankesë OSHP-së. Neni 108/A paragrafi 3.2 i LPP-së përcakton se operatori ekonomik ankues kërkesën për shqyrtim duhet të dorëzoj tek autoriteti përkatës kontraktues: *në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit, brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së njoftimit për dhënien e kontratës ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit që i është dërguar ankuesit.* Po ashtu, edhe neni 60.1 pika b) në Rregulloren 001/2022 për Prokurim Publik përcakton se: *Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së publikimit të njoftimit mbi vendimin e AK (B58) ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit në sistem të prokurimit elektronik. Në kalkulim të afateve kohore, dita e publikimit të Njoftimit mbi vendimit të AK (B58) është dita (0).* OSHP sqaron se konform nenit 3 paragrafi 3.17 të Rregullores për Prokurim Publik Nr.001/2022 OE ankues e ka pranuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës

22.09.2023 sepse "*Të gjithë përdoruesit e rexhistruar dhe aktiv të Autoriteteve Kontraktuese, Operatorëve Ekonomik ose si person fizik pranojnë mesazhe (e-maila) të dërguar në mënyrë automatike nga sistemi i prokurimit elektronik. Pranimi i mesazheve bëhet në "Inbox" mbrenda llogarisë së krijuar në sistem të prokurimit elektronik dhe në e-mailin privat të përdoruesit. KRPP mbanë përgjegjësi vetëm për e-mailat automatik të dërguar/pranuar në inbox të llogarisë së përdoruesit brenda sistemit të prokurimit elektronik.* P*ërdoruesit e sistemit të prokurimit elektronik gjithmonë duhet të kontrollojnë inboxin e llogarisë mbrenda sistemit të prokurimit elektronik*."

Andaj nga provat e prezantuara si më sipër konstatohet se ankesa e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me datë 30.10.2023 nga OE "WOOD CORPORATION" L.L.C., për aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi dhe montimi me inventar te çerdheve", me numër të prokurimit 208 Udheheqesi-23-1185-1-1-1, inicuar nga Ministria e Arsimit, hedhet si e pa lejuar sepse ankuesi nuk ka parashtruar kërkesën për rishqyrtim brenda afateve ligjore kundër njoftimit të Autoritetit Kontraktues B58. Andaj Organi Shqyrtues i Prokurimit sqaron se vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake të rregullt dhe brenda afateve ligjore pranë AK, ankuesi mund ti drejtohet me ankesë OSHP-së. Si përfundim kjo ankesë është në kundërshtim me nenin 108/A dhe 109 të Ligjit për Prokurim Publik, dhe nenit 60 të Rregullores 001/2022 për Prokurim Publik, dhe si e tillë hedhet si e pa lejuar dhe nuk hynë në shqyrtim nga OSHP.

Organi Shqyrtues i Prokurimit sqaron se ky vendim ka karakter procedural kurse AK mban përgjegjësi për zhvillimin e mëtutjeshëm të këtij aktiviteti, konform dispozitave dhe autorizimeve ligjore siç përcaktohen me nenin 1, 6, 7,24.2 cituar: *Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj lidhur me nenin* 27, 28, 59, 60 dhe 65 të LPP-së.

Lidhur me tarifën ankimore vendoset në përputhje me 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Kryetarja e OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vjosa Gradinaj
Kryetare e OSHP-së

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **MINISTRIA E ARSIMIT**
- OE - **WOOD CORPORATION L.L.C.**
- Arkivës së OSHP-së: